



Pranuar / Dorezuar Prijeno/Pridato Received/Delivry		12. 01 2021	1	viti god year
Organ /Mjesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Hr Prot Prot No	Shtimi e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHOK	109/2021		1:1:3	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.395/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyll Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.395/2020 të datës 04.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Shefqet Shkupi", B/41 në Prishtinë, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministritë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës/mos vazhdim i kontratës së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.395/2020 e datës 04.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 04.12.2020 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2956/2020 të regjistruar me numër A.nr.395/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës/Ministritë së Punëve të Brendshme, lidhur me mos vazhdimin e mandatit si Sekretar i Përgjithshëm i Ministritë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 14.12.2020 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Sekretariati Koordinuar në kuadër të Zyres së Kryeministrit, si dhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Këshilli më datë 30.12.2020 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Zyra e Kryeministrit, ndërsa me datë 05.01.2021 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.12.2020 me Nr.prot:2956/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës: Njoftimin e datës 05.10.2020 të Ministrit së Punëve të Brendshme; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës të datës 28.12.2018, 10.07.2020 dhe të vitit 2017 për ankuesin; Vendimin me Nr.13/149 të datës 17.07.2017 të Qeverisë së Kosovës për vazhdimin e mandatit të ankuesit si Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Vendimin me Nr.03/03 të datës 19.02.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 30.12.2020 të dërguar nga N.T; E-mailin e datë 31.12.2020 të dërguar nga N.G për A.B; E-mailin e datës 31.12.2020 nga A.B për T.B; E-mailin e datës 05.01.2021 nga N.T për A.B; Vendimin me Nr.09/16 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me Nr.05/194 të datës 23.07.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; E-mailin e datës 05.01.2021 nga L.B për A.B; Vendimin e datës 20.07.2020 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pa lejuar sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Vendimit Nr.09/16 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 25.05.2011 është emëruar në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me mandat tre (3) vjeçar. Përmes Vendimit Nr.05/194 të datës 23.07.2014 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ankuesit i është vazhduar mandati për tre (3) vite, ndërsa me Vendimin Nr.13/149 të datës 17.07.2017, ankuesit i është vazhduar mandati edhe për tri (3) vite tjera, deri më datë 17.07.2020, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Emërimi i ankuesit në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm është bërë sipas dispozitave të nenit 15 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Pas përfundimit të mandatit të ankuesit sipas Vendimit Nr.13/149 të datës 17.07.2017, Ministria e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 20.07.2020 ka nxjerr Vendimin me Nr.2495/2020 përmes të cilit ka caktuar zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, deklaroi se bazuar në Vendimin Nr.13/149 për zëvendësimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 17.07.2020, i është kërkuar ta lirojë zyrën dhe të përfundojë ushtrimin e detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, kështu që ankuesi pretendon se është diskriminuese mos dhënia e mundësisë për ri zgjatjen e mandatit sipas nenit 42 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. *Ankesa*

duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Vendimin Nr.13/149 të datës 17.07.2020 për zëvendësimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe deklaratën e ankuesit ku thuhet se me datë 17.07.2020, i është kërkuar ta liroje zyrën dhe të përfundojë ushtrimin e detyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 04.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.395/2020

Avdyl BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Jeton KOÇA


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.